

**Akt Themelimi**  
**i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“Express Cargo Forwarding” SHPK**

**Radit GJEÇI**, i biri i Foto GJEÇI, lindur në Durrës, më 17.08.1980 dhe banues në Tiranë në adresën Rruga Myslym Shyri, P.1, Sh.7, Ap.113, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet mjetit të identifikimit, Kartë Identiteti me nr. 029346086

**Fluesa SELAMAJ**, e bija e Isa SELAMAJ, lindur në Sarandë, më 09.01.1982 dhe banuese në Tiranë në adresën Rruga “Frang Bardhi”, Godina A3, Hyrja 2/11 Qendra Kristal, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nëpërmjet mjetit të identifikimit, Kartë Identiteti me nr. 024576509.

vendosën të hartojë këtë Akt Themelimi, mbështetur në të dhënat e mëposhtme:

**NENI 1**  
**DATA E THEMELIT**

Sot, më datë 01/02/2017 themeluesit Z. Radit GJEÇI dhe Znj. Fluesa SELAMAJ vendosën të krijojë një shoqëri me emërtimin “Express Cargo Forwarding” SHPK.

**NENI 2**  
**FORMA E SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

**NENI 3**  
**EMËRTIMI**

Emri i plotë i shoqërisë është “Express Cargo Forwarding” SHPK.

**NENI 4**  
**SELIA**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Njësia Bashkiake nr.5, Selitë, Ndërtesë përdhese, Zona Kadastrale nr.3292, Nr.Pasurie 28/4/1. Me vendim të Asamblesë së



Përgjithshme selia e shoqërisë mund të ndryshohet, mund të hapen degë, dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

## **NENI 5 KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë, ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## **NENI 6 OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria “**Express Cargo Forwarding**” SHPK si objekt të veprimtarisë do të ketë shërbime të logjistikës dhe transportit ajror, tokësor dhe detar. Do të ofrojë shërbime të procedurave të ndryshme në lidhje me transportet. Transport mallrash brenda vendit për qëllimet e vet shoqërisë dhe për të tretë.

## **NENI 7 KAPITALI**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (njëqind mijë) Lekë, të zotëruar nga ortakët si më poshtë:

<b>Emri, Mbiemri</b>	<b>% që zotëron</b>	<b>Kuotat që zotëron</b>
<b>Radit GJEÇI</b>	70%	1 kuote
<b>Fluesa SELAMAJ</b>	30%	1 kuote

Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota të zotëruara nga ortakët sipas pasqyrës së mësipërme. Secila prej kuotave ka vlerë 50 (pesedhjetë mijë) Lekë.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.



**NENI 8**  
**ADMINISTRATORI**

Administratore e parë e shoqërisë do të jetë Znj. Fluesa SELAMAJ. Kohëzgjatja e mandatit të saj është 2 (dy) vjet me të drejtë ripërtëritje.

**NENI 9**  
**DISPOZITA E FUNDIT**

Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore, nga të cilat një kopje për tu dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe një kopje për tu disponuar në dosjen e shoqërisë.

Të dhënat tregtare të detyrueshme si dhe të dhënat e tjera për shoqërinë e sapokrijuar gjenden të detajuara në Statutin e shoqërisë bashkangjitur.

**THEMELUESIT**

**Fluesa SELAMAJ**

Fluesa Selamaj  


**Radit GJEÇI**

Radit Gjeçi  
